EMBASSY OF THE UNITED STATES
SKOPJE • MACEDONIA

Ambasadori Wohlers në Tetovë për Natën e shtrigave

Në 1 nëntor, Këndi amerikan në Tetovë, i ndihmuar nga vullnetari i Korpusit të paqes Cara Bradley, stafi i Këndit dhe stazhistët, organizuan një eveniment për Natën e shtrigave ku u mblodhën rreth 30 nxënës prej moshës 5-13 vjeç. Ambasadori Wohlers i befasoi fëmijët duke iu bashkangjitur festimit si i ftuar i veçantë derisa ata po luanin lojën "Përcille më tej kungullin." Para se të fillonte festimi "Mashtro ose qeras" me ëmbëlsira amerikane, ambasadori u nderua me një interpretim të veçantë të "Këngë e frikshme". Mediat lokale mbuluan këtë eveniment të hareshëm.